

## Projekti “Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri”

### KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E INSTITUCIONEVE ARSIMORE të sistemit të arsimit bazë dhe të mesëm të lartë që do të jenë pjesë e projektit “Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri”

#### 1. Konteksti

Projekti “**Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri**” zbatohet nga Këshilli i Evropës dhe financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida). Projekti do të zbatohet për një periudhë katër-vjeçare. Projekti synon të përmirësojë cilësinë e arsimit parauniversitar në Shqipëri, duke forcuar kapacitetet e sistemit arsimor që zhvillojnë kompetencat e nxënësve për kulturë demokratike, në përputhje me instrumentet dhe qasjet e Këshillit të Evropës.

Projekti do të përkrahë reformën aktuale të kurrikulave shkollore, bazuar në *kompetenca* dhe qasjet e reja të arsimit që ato përfshijnë, si dhe metodat e mësimdhënies me në qendër nxënësin.

Projekti përgjatë tre viteve do të mbështesë 75 shkolla pilot të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë (ndarë në tre cikle, 25 shkolla të përzgjedhura për secilin vit), për të zhvilluar dhe zbatuar kulturën demokratike, politikat dhe praktikat për qeverisje demokratike në shkollë, me synimin për të krijuar një mjedis nxënës e gjithëpërfshirës dhe për të gjithë nxënësit. Secili nga tre ciklet do të zhvillohet gjatë një viti shkollor. Përpara çdo cikli do të kryhet një skemë e granteve të vogla për Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC), dhe 5 Organizata të Shoqërisë Civile do të marrin mbështetje financiare të cilën ato do ta përdorin për të punuar në shkolla dhe për të zhvilluar dhe zbatuar projekte të propozuara dhe udhëhequra nga vetë nxënësit në shkollat dhe komunitetet e tyre. Çdo vit, shkollave do t’u ofrohet një temë e ndryshme që lidhet me aftësitë, vlerat, qëndrimet dhe njohuritë e Kuadrit të Kompetencave për Kulturë Demokratike.

Do të krijohet një rrjet shkollash demokratike që do të shërbejnë si bashkësi dhe do të ofrojnë platforma inovatore për përhapjen e modeleve më të mira shkollore në mbarë vendin. Nxënësit, mësuesit dhe stafi drejtues i shkollës do të kenë mundësinë të marrin pjesë në veprimtaritë e shkëmbimeve të përvojave (*peer learning*), aktivitetet ndërgjegjësuese, shkollat verore dhe rrjetet e punës.

#### 2. Kriteret e përzgjedhjes

Kriteret e mëposhtme janë hartuar për përzgjedhjen e 25 shkollave të para pilot.

### **Kriteri 1: Prania e praktikave arsimore gjithëpërfshirëse**

Shkollat duhet të vërtetojnë aftësinë e tyre për të krijuar mjedise arsimore gjithëpërfshirëse, pavarësisht përbërjes së ndryshme socio-ekonomike, kulturore, fetare dhe gjuhësore të zonës ku ato janë vendosur, si dhe të tregojnë aftësinë për të përqafuar diversitetin përmes praktikave arsimore gjithëpërfshirëse.

### **Kriteri 2: Vendosmëria dhe gatishmëria për të demokratizuar më tej kulturën e qeverisjes në shkollë**

Shkollat duhet të tregojnë përkushtim për të forcuar më tej qeverisjen demokratike me anë të veprimtarive shkollore dhe jashtëshkollore, duke përfshirë përdorimin e qasjes mbarëkomunitare. Stafi drejtues i shkollës prezanton praktikën e mira të pjesëmarrjes së nxënësve në jetën e përditshme shkollore dhe garanton se qeveria e nxënësve në shkollë dhe përfaqësimi në Parlamentin e Nxënësve është aktiv dhe se zëri i tyre dëgjohet. Mësuesit dhe stafi i shkollës garantojnë se të gjitha fushat e veprimtarive në shkollë pasqyrojnë vlerat demokratike dhe mbrojnë të drejtat e njeriut.

### **Kriteri 3: Nxitja e qasjeve bashkëpunuese dhe ndërvepruese të mësimnxënies dhe mësimdhënies**

Shkollat duhet të tregojnë se janë të gatshme të nxisin mësimdhënien dhe mësimnxënien bashkëpunuese dhe ndërvepruese. Shkollat duhet të tregojnë gatishmëri për të bashkëpunuar me Organizatat e Shoqërisë Civile dhe zbatuar projektet e propozuara dhe të drejtuara nga nxënësit.

### **Kriteri 4: Konsiderata për diversitetin**

Përbërja e shkollave pjesëmarrëse në këtë projekt duhet të jetë sa më e ndryshme dhe gjithëpërfshirëse (ndryshimet ekonomike, sociale, kulturore, fetare, gjuhësore, dhe urbane/rurale).

Në fazën e parë të projektit pritet të përzgjidhen **15 shkolla të arsimit bazë dhe 10 shkolla të arsimit të mesëm të lartë.**

Procesi i aplikimit do të jetë i hapur për shkolla publike dhe jo-publike.

Në kampionin e shkollave pilote, do të ketë një ndërthurje të shkollave rurale, periferike dhe urbane. **Të paktën 20% e shkollave duhet të jenë nga zonat rurale.**

Shkollat duhet të kenë një përfaqësim të balancuar gjeografik dhe duhet të zgjidhen nga 4 rajone të Shqipërisë. Përzgjedhja e shkollave pilote do të jetë:

- 10 shkolla nga rajoni Tiranë/Durrësi,
- 5 shkolla nga rajoni Fier,
- 5 shkolla nga rajoni Lezhë
- 5 shkolla nga rajoni Korçë.

### **Kriteri 5: Përfshirja e mëparshme në projekte në fusha të lidhura me kulturën dhe qeverisjen demokratike të shkollës.**

Përparësi do t'i jepet shkollave që nuk kanë përfituar nga projekte të organizuara nga KiE ose nga organizata të tjera. Megjithatë, me qëllim që të lehtësohet mësimi midis shkollave, për projektin do të ishte e vlefshme, nëse, të paktën, 5 shkolla të arsimit bazë dhe 3 shkolla të arsimit të mesëm kanë përvojë të mëparshme në zbatimin e politikave dhe praktikave që lidhen me arsimin gjithëpërfshirës.

#### **3. Procedura e përzgjedhjes**

**Përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë, do të dakordësojnë bashkërisht përzgjedhjen e 25 shkollave të para pilot në Shqipëri, duke mbajtur parasysh kriteret e përcaktuara të përzgjedhjes.**

Për të kryer një proces të hapur dhe transparent përzgjedhës, projekti i ofron mundësi të gjitha shkollave të interesuara, që plotësojnë kriteret, të aplikojnë. Me qëllim që të mësojnë nga njëri-tjetri, do të përzgjidhen një ndërthurje shkollash **me nivele të ndryshme të praktikave të kulturës dhe qeverisjes demokratike.**

Thirrja do të jetë e hapur për të gjitha shkollat e sistemit arsimor parauniversitar në vend, por prioritet do t'i jepet shkollave publike.

Thirrja do të shpërndalet nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar.

Shkollat e interesuara, për të qenë pjesë e projektit, duhet të plotësojnë **Formularin e Aplikimit** dhe të dërgojnë dokumentet e mëposhtme mbështetëse:

1. Plani i Zhvillimit ose Plani i Veprimit të shkollës
2. Letër mbështetjeje nga Bordi i Shkollës, për pjesëmarrjen e shkollës në projekt

#### **4. Afatet Kohore të procedurës së përzgjedhjes**

- |  |                        |
|--|------------------------|
| - Publikimi i thirrjes për shprehje interesi:        | <b>15 korrik 2020</b>  |
| - Afati për të aplikuar                              | <b>31 korrik 2020</b>  |
| - Lista përfundimtare e 25 shkollave të para pilot : | <b>15 shtator 2020</b> |